

Raport Monitorimi i realizimit të zbatimit të Planit të Integritetit 2023

Bashkia Pukë

Përmbajtja

I. Hyrje	Error! Bookmark not defined.
I. Monitorimi i PI për bashkinë Pukë Viti 2023.	Error! Bookmark not defined.
I.1 Qasja Vlerësuese	Error! Bookmark not defined.
I.2 Metodologjia e vlerësimit.	Error! Bookmark not defined.
I.3 Mbledhja dhe analiza e të dhënave	Error! Bookmark not defined.
II. Gjetjet e Raportit	Error! Bookmark not defined.
III. Konkluzione dhe Rekomandime	Error! Bookmark not defined.

Lista e Figurave

Figura 1: Statusi i Zbatimit të Masave	Error! Bookmark not defined.
Figura 3: Statusi i Zbatimit të Masave, Objektivi I.....	Error! Bookmark not defined.
Figura 4: Statusi i Zbatimit të Masave, Objektivi II	Error! Bookmark not defined.
Figura 5: Statusi i Zbatimit të Masave, Objektivi III.....	Error! Bookmark not defined.

Hyrje

Integriteti institucional dhe lufta kundër korrupsionit konsiderohen si një nga prioritetet kryesore të qeverisë shqiptare. Në kontekstin e sektorit publik, integriteti konsiston në përmbushjen e detyrimeve të transparencës, llogaridhënies, etikës, ndershmërisë, efektivitetit dhe efikasitetit në kryerjen e detyrave dhe të ushtrimit të funksioneve rregullatore dhe administrative.

Miratimi dhe monitorimi i politikave kundër korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore është jetësuar nëpërmjet koordinimit dhe zbatimit të nismave anti-korrupsion të parashikuara në Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK) 2015-2023. Ndërkohë menaxhimi i riskut të integritetit për NJVV-të, si proces në vetëvete rrjeth nga objektivi specifik (objektivi A11) i SNKK dhe Planit të Veprimit (2018-2023), miratuar me VKM nr.516, datë 1.7.2020, si dhe qëllimit politik 5 të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030 (SNDQV) - objektivi specifik 5.2: “Nxitja e politikave kundër korrupsionit në nivel vendor dhe konsolidimi i mëtejshëm i arritjeve mbi integritetin”, miratuar me VKM nr.252, datë 21.04.2023”. Ky proces vjen në linjë edhe me rekomandimet e Komisionit Evropian (2018) për Shqipërinë në kuadër të integritetit në Bashkimin Evropian, ku një nga rekomandimet e dhëna është zbatimi i dokumentit të Strategjisë Kundër Korrupsionit, duke iu referuar konkretisht mungesës së një sistemi funksional të menaxhimit të integritetit në institucionet publike në vend.

Procesi i menaxhimit të riskut të integritetit në nivel vendor, ka një qasje gjithëpërfshirëse ku angazhohen të gjitha strukturat e brendshme të bashkisë. Ndërsa hapi i parë i tij lidhet me hartimin e Planit të Integritetit për njësinë vendore (detajuar ky i fundit edhe me një Plan Veprimi 3-vjeçar), monitorimi dhe raportimi i planit të integritetit është etapa tjetër e menaxhimit të riskut në bashki. Monitorimi është periodik (çdo vit) dhe përfshin kryerjen e aktiviteteve nga ana e punonjësve dhe drejtuesve të bashkisë, për zbatimin e masave të miratuara për trajtimin e risqeve, në përputhje me përgjegjësitë që ata kanë. Ndërkaq raportimi është një procedurë e rregullt që siguron zbatimin e Planit të Veprimit për risqet e integritetit, sipas afateve kohore të parashikuara, për periudhën e kërkuar, për statusin e zbatimit të tyre për problematikat e hasura në zbatim si dhe përmban të dhëna për veprimtarinë e brendshme kontribuese, referuar kuadrit të brendshëm rregullator, burimeve njerëzore profesionale të qëndrueshme, si dhe transparencës e komunikimit me grupet e interesuara.

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) në kuadër të funksioneve të saj për realizimin e objektivave të Qeverisë Shqiptare për garantimin e qeverisjes së mirë, ka vijuar me procesin e monitorimit të zbatimit të planeve të integritetit në nivel bashkie për vitin 2023. Raporti i monitorimit është hartuar në përputhje me metodologjinë e monitorimit të Planit të Integritetit për institucionet e qeverisjes qëndrore. Analiza e të dhënave dhe vlerësimi i progresit të zbatimit të Planit të Veprimit të Planit të Integritetit për këtë periudhë raportimi është bërë në zbatim të Urdhrit nr. 553, datë 30.09.2021 “*Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të Planit të Integritetit për institucionet e qeverisjes qëndrore*”.

Raporti i Monitorimit të PI për bashkinë Pukë Viti 2023.

Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të bashkisë Pukë për vitin 2023, është i dyti dokument i hartuar në përputhje me Metodologjinë e Monitorimit të Planit të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore, të miratuar me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë 553, datë 30.09.2021.

Në Planin e Integritetit të bashkisë , janë përcaktuar gjithsej 3 objektiva, për të cilat janë parashikuar fushat me risk dhe masat dhe aktivitete për realizimin e tyre, si vijon:

Objektivi I “Përmirësimi i kuadrit rregullator të bashkisë mbi aspekte të etikës dhe integritetit sipas fushave funksionale të bashkis”.

Objektivi II “Menaxhim efektiv i riskut të integritetit me fokus fushat e përgjegjësisë së bashkisë. **Objektivi III** “Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore në gjitha nivelet dhe funksionet në bashki”.

Plani i Integritetit, është konceptuar i shtrirë në një periudhë 3-vjeçare dhe konkretisht 2022-2025.


Për bashkinë Pukë Plani i Integritetit për periudhën Janar-Dhjetor 2023, referuar në planin e veprimit janë planifikuar 51 aktivitete/masa për tu realizuar.

Situata e monitorimit të Planit të Integritetit Bashkia Pukë për periudhën janar – dhjetor 2023, rezulton si më poshtë:

Nga monitorimi i procesit rezulton se, në totalin prej 67 masash (aktivitetesh) të parashikuara për zbatim për vitin 2023, janë **realizuar** 42 masa/aktivitete ose 62% , **në proces realizimi 14 masa/aktivitete ose 21 %** dhe **të porealizuara** 11masa/aktivitete ose 17% .

Bashkia Pukë	Masa dhe Aktivitete	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2023	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete në proces	Masa dhe aktivitete të porealizuara
Realizimi në total i objektivave të PI		67	42	14	11

STATUSI I ZBATIMIT TË MASAVE



Sa më sipër, gjatë vitit 2023, bashkia Pukë ka hartuar dhe miratuar disa dokumente strategjike për aspekte të veçanta të integritetit si, në përmirësimin e kuadrit të brendshëm rregullator institucional, zhvillimin e burimeve njerëzore, rritjen e rezistencës institucionale ndaj risqeve të integritetit në fusha të ndryshme të përgjegjësisë së bashkisë.

Qasja Vlerësuese

Raporti i monitorimit të zbatimit të planit të integritetit të bashkisë përmban një analizë të përgjithshme të zbatueshmërisë dhe progresit të vitit 2023, për aktivitete dhe masat të kuadrit riskut në fusha të veçanta të përgjegjësisë rregullator të performancës institucionale, si dhe për ti rezistuar shkeljeve të integritetit.

Metodologjia e vlerësimit.

Ky raport është hartuar në bazë të kontributit të dhënë nga drejtoritë dhe strukturat teknike të bashkisë, bazuar në aktivitetet dhe masat e parashikuara për zbatim për vitin 2023, në planin e veprimit të Planit të Integritetit dhe ecuria e deritanishme e tyre.

Mbledhja dhe analiza e të dhënave.

Të dhënat e këtij raporti janë grumbulluar nga Koordinatori i Integritetit të bashkisë në përmbushje të rolit të tij si struktura e posaçme përgjegjëse për mbledhjen dhe analizën e informacionit mbi ecurinë e raportit të monitorimit.

Gjetjet e Raportit

Objektivi I “Përmirësimi i kuadrit rregullator të bashkisë mbi aspekte të etikës dhe integritetit sipas fushave funksionale të bashkisë”


Ky objektivi adreson nevojën për rishikim të kuadrit rregullator të integritetit duke e përditësuar me parashikimet ligjore në fuqi për aspekte të integritetit si p.sh konflikti i interesit, sinjalizimi, e drejta për informim etj. Më tej, nëpërmjet përmirësimit të kuadrit rregullator synohet qartësimi i funksioneve e detyrave të njësive në bashki dhe pasqyrimi i ndryshimeve që ka pësuar struktura institucionale.

Ky objektivi për vitin 2023 përmban 23 masa/aktivitete specifike të planifikuara për tu zbatuar nga njësitë e përfshira, të cilat i referohen mjedisit të brendshëm institucional që promovon dhe garanton integritetin në të gjitha nivelet organizative nga të cilat janë realizuar 11.masa/aktivitete ose 48% janë në proces 5 masa/aktivitete ose 22% dhe nuk janë realizuar 7 masa/aktivitete ose 30% sipas tabelës dhe grafikut si më poshtë:

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat/ aktivitetet planifikuar për këtë objektivi sipas tabelës dhe grafikut, si më poshtë:

Objektivi I	Masa dhe Aktivitete	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2023	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete në proces	Masa dhe aktivitete të përealizuara
<i>Përmirësimi i kuadrit rregullator të bashkisë mbi aspekte të etikës dhe integritetit sipas fushave funksionale të bashkisë</i>		23	11	5	7

REALIZIMI I MASAVE DHE AKTIVITETEVE



Për këtë periudhë monitorimi Janar- Dhjetor 2023 ky objektivi është realizuar në masën 48% ku rezultojnë të realizuara masat /aktivitetet si më poshtë:


- Hartimi i rregullave të brendshme për përgatitjen e Paketës së Taksave dhe Tarifave Vendore në bashki, duke përcaktuar rolin dhe detyrat e secilës drejtori të përfshirë.
- Informimi i personelit të të gjithë drejtorive mbi këto rregulla
- Publikimi i tyre në Programin e Transparencës.
- Hartimi i rregullave të brendshme për përgatitjen e Paketës së Taksave dhe Tarifave Vendore në bashki, duke përcaktuar rolin dhe detyrat e secilës drejtori të përfshirë
- Vendosja e kriterëve të paracaktuara dhe të matshme lidhur me performancën e instrumentit të zgjedhur të shërbimit publik
- Hartimi i një PSV-je për proceset e punës që administrojnë Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit Vendor në Bashki
- Informimi i punonjësve në lidhje me këtë PSV
- Publikimi i PSV-së në Programin e Transparencës
- regjistri për KI-në, të plotësohet dhe të raportohet rast pas rasti
- Informimi i personelit të bashkisë në lidhje me regjistrin e KI-së dhe detyrimet përkatëse për deklarimin e konfliktit të interesit dhe regjistrimin e dhuratave

Objektivi II “*Menaxhim efektiv i riskut të integritetit me fokus fushat e përgjegjësisë së bashkisë.*”.

Ky objektivi synon menaxhimin e risqeve të identifikuara në kuadër të fushave të përgjegjësisë së bashkisë si, paqartësi rreth proceseve e procedurave të punës, linjave të hierarkisë dhe raportimit, rregullimi i ulët normativ i proceseve, kapacitetet njerëzore të pamjaftueshme dhe të kufizuara teknike, mbingarkesa në punë, bashkëpunim i ulët ndërmjet drejtorive të bashkisë, infrastruktura e kufizuar fizike, pajisjet e pamjaftueshme në bashki etj.

Gjatë periudhës raportuese lidhur me këtë objektivi janë planifikuar për vitin 2023 për tu realizuar 23 masa/aktivitete nga të cilat janë realizuar 16 masa/aktivitete ose 61%, janë në proces realizimi 6 masa/aktivitete ose 26 % dhe nuk janë realizuar 3 masa/aktivitete ose 13 % , sipas tabelës dhe grafikut si më poshtë:

Objektivi II	Masa dhe Aktivitete	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2023	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete në proces	Masa dhe aktivitete të përfunduara
	<i>Menaxhim efektiv i riskut të integritetit me fokus fushat e përgjegjësisë së bashkisë</i>	23	14	6	3



Për këtë periudhë monitorimi Janar Dhjetor 2023 ky objektiv është realizuar në masën 69% ku rezultojnë të realizuara masat /aktivitetet si më poshtë:

- Të rishikohen metodat e planifikimit buxhetor për zërin e të ardhurave për të pasur një parashikim realist.
- Të sigurohet një bazë e plotë e të dhënave të nevojshme dhe sistemi i kontrollit përkatës.
- Asistencë trajnuese për burimet njerëzore të përfshira në proces.
- Plan Pune nga ana e Bashkisë për realizimin e të ardhurave të parashikuara.
- Parashikimi i rregullave të qarta për ndryshimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik në rastet e emergjencave..
- Krijimi i Planit të vijueshmërisë për rastet e emergjencave, si referencë për ndryshimet që mund të ndodhin në regjistrin e parashikimit të prokurimeve.
- Shoqërimi me dokumentacionin e nevojshëm të çdo ndryshimi që pëson grafiku i prokurimeve dhe vendimmarrja e dakorduar nga Këshilli Bashkiak /Kryetari.
- Parashikimi në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë i detyrimeve të njëjësive të bashkisë në lidhje me gjurmueshmërinë e informacionit.
- Të rishikohet metodologjia e planifikimit të financimit të shërbimeve bazë për garantimin e qëndrueshmërisë së tyre.
- Vlerësimi i situatës aktuale dhe nevojave për sa i përket burimeve njerëzore dhe kapaciteteve teknike për ngritjen dhe funksionimin e Inspektoriatit Vendor të Mbrojtjes së Territorit etj.


Objektivi III “Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore në gjitha nivelet dhe funksionet në bashki”.

Përmirësimi i proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore në bashki do të sigurojë kapacitetet dhe aftësitë e nevojshme për të aktivizuar dhe konsoliduar mekanizmat që garantojnë dhe mbrojnë integritetin në institucion. Ruajtja e një niveli të lartë integriteti në proceset e menaxhimit të burimeve njerëzore garanton në vijimësi standarde sjelljeje dhe performancë të dëshirueshme nga stafi dhe drejtuesit e të gjitha niveleve në bashki.

Gjatë periudhës raportuese lidhur me këtë objektivi janë planifikuar për vitin 2023 për tu realizuar 21 masat/aktivitete nga të cilat janë realizuar 18 masa/aktivitete ose 80% janë në proces realizimi 3 masa/aktivitete ose 14% dhe nuk janë realizuar 1 masë/aktivitet ose 6 %, sipas tabelës dhe grafikut si më poshtë:

Objektivi III	Masa dhe Aktivitete	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara per vitin 2023	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete në proces	Masa dhe aktivitete te perealizuara
	<i>Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore në gjitha nivelet dhe funksionet në bashki</i>	21	17	3	1

REALIZIMI I MASAVE DHE AKTIVITETEVE



Për këtë periudhë monitorimi Janar Dhjetor 2023 lidhur me këtë objektiv, bashkia ka realizuar, masat dhe aktivitete si më poshtë:

- Trajnimi i personelit të sektorit të prokurimeve publike rreth legjislacionit mbi prokurimet publike.
- Vlerësim i situatës aktuale të burimeve njerëzore dhe kapaciteteve teknike në Bashkinë Pukë.
- Planifikim i burimeve të domosdoshme për realizimin optimal të objektivave në përputhje me rezultatet e analizës së vlerësimit të situatës..
- Plan për rekrutimin e kapaciteteve teknike më të domosdoshme sipas detyrave funksionale.
- Rishikimi i formularit të vlerësimit të performancës në punë duke shtuar një rubrikë fakultative për vlerësimin e detyrave shtesë të ushtruara nga personeli, si pjesë e procesit të menaxhimit të performancës.
- Detajimi i rubrikës “detyra të tjera” në përshkrimet e punës për cdo pozicion në bashki, si të lidhura me detyrat parësore.
- Emërimi i një personi të dedikuar për detyrën e Koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik.

- Krijimi i bazës rregullatore përkatëse në lidhje me procedurat për grumbullimin, përpunimin dhe rrjedhën e informacionit nga sektorët funksionalë të Zyra e Shërbimit me një ndalesë.
- Informimi i punonjësve të bashkisë në lidhje me këto rregulla.
- Përmirësimi i rrjetit digjital për transferimin e informacionit të brendshëm që furnizon Zyrën e Shërbimit me një Ndalesë.
- Vlerësim i situatës aktuale të burimeve njerëzore dhe kapaciteteve teknike në Drejtorinë e Urbanistikës.
- Plan për rekrutimin e kapaciteteve teknike sipas detyrave funksionale.
- Planifikim i burimeve të domosdoshme për realizimin optimal të objektivave në përputhje me rezultatet e analizës së vlerësimit të situatës. etj.

Gjetje të tjera:

- ✚ Të vijohet puna në fushën e përmirësimit të kuadrit rregullator të bashkisë mbi aspekte të etikës dhe integritetit sipas fushave funksionale të bashkisë
- ✚ Hartimi dhe miratimi i Kodit të Etikës për Audituesin e Brendshëm.
- ✚ Hartimi dhe miratimi i Deklaratës së Auditit të Brendshëm.
- ✚ Parashikimi në Rregulloren e Brendshme e detyrimit të bashkisë për ndarjen e raportit të Auditimit të brendshëm me strukturat e bashkisë
- ✚ Hartimi, miratimi dhe publikimi i Raportit Vjetor të Transparencës
- ✚ Hartimi dhe miratimi i një PSV-je për procesin e monitorimit të performancës së shërbimit, duke përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë e njësive përkatëse dhe duke vendosur kritere të matshme (indikatore) për administrimin e performancës së shërbimit publik
- ✚ Realizimi i monitorimeve periodike të performancës dhe kryerja e një analize mbi këtë proces
- ✚ Të alokohen burime financiare në buxhet, sipas listës së prioriteteve të Bashkisë për përfundimin e certifikatave të pronësisë së pronave bashkiake.
- ✚ Digjitalizim i pronave bashkiake të azhuruara dhe të inventarizuara
- ✚ Kryerja e një vlerësimi mbi nevojën për të kategorizuar Fondin Arkivor si njësi më vete

Konkluzione dhe Rekomandime

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për vitin 2023, të gjetjeve që ky document na ofron, të dhënave analitike të raportuara dhe të analizës së kryer, rezultojnë se:

- Bashkia Pukë ka vijuar me zbatimin e planit të Integritetit duke realizuar një nivel të mirë të realizimit të masave /aktiviteteve në 62 % të realizimit të masave të planifikuara për integritetin (61-80) për vitin 2023, për sa i përket realizimit të objektivave ka arritur një nivel shumë të mirë realizimi në objektivin e tretë të menaxhimit të burimeve njerëzore 80% (61-80) % duke sjellë një impakt pozitiv në përmirësimin e rritjes të trajnimeve dhe ndërgjegjësimit dhe edukimit të punonjësve ku ndërgjegjësimi dhe edukimi i tyre rreth rreziqeve të korrupsionit dhe rëndësisë së veprimtimit etik janë të rëndësishme për suksesin e planit të integritetit.

- ✓ Të vijohet me zbatimin dhe raportimin e masave dhe angazhimeve të evidentuara më sipër që vijojnë të jenë në proces apo janë të porealizuara, sipas fushave të etikës, burimeve njerëzore dhe fushave të veçanta të përgjegjësisë
- ✓ Të fokusohet vëmendja në realizimin e masave/aktiviteteve sipas fushave të ndyshme funksionale në nivel bashkie
- ✓ Përmirësimi i kapaciteteve në strukturat/institucionet përkatëse për zbatimin dhe raportimin sipas metodologjisë së monitorimit të PI.